

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

midis

Kolegjit Universitar “LUARASI”

dhe

KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Kolegji Universitar “LUARASI” person juridik i themeluar me vendim gjykate Nr. 28233 datë 02/09/2002, me adresë në: Rr e Elbasanit, Nd.59, H.1, Kodi Postar 1010, Njësia Admin 2 – TiranëTiranë, Shqipëri me Nr. Identifikimi (NIPT) K31526058G, përfaqësuar për lidhjen e kësaj Marrëveshjeje nga Rektori Prof.Dr. Et’hem Ruka,

dhe

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI (KMD) si institucion i pavarur i cili funksionon në bazë të ligjit Nr. 10 221, datë 14.02.2010 “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”, me adresë në: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri përfaqësuar për lidhjen e kësaj Marrëveshjeje nga z. Robert Gajda, Komisioneri.

(secila prej tyre, këtu e më poshtë, referuar si “Pala” dhe të dyja sëbashku “Palët”) bien dakord për të nënshkruar këtë Marrëveshje Bashkëpunimi si më poshtë vijon:

Duke qenë se:

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

është institucioni që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin;

ka kompetenca të nxisë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje dhe të zhvillojë aktivitete ndërgjegjësimi dhe edukimi

Kolegjit Universitar “LUARASI”:

Në funksion të:

- nevojave për zhvillimin e procesit mësimor si dhe realizimin e programit kërkimor e shkencor në fushat e Menaxhimit, Financës dhe teknologjise se Informacionit dhe Inovacionit,
- lidhjes së kërkimit shkencor me veprimtaritë financiare (bankare dhe jobankare), private dhe industrinë;
- rritjes së angazhimit dhe veprimtarive në ndihmë të komunitetit;

shprehin interesin për vendosjen dhe zhvillimin e bashkëpunimit mes tyre.

Neni 1

Palët në bashkëpunim me njëra-tjetrën, dhe në masën që nuk cënon ndërsjelltas interesat dhe veprimtaritë e tyre, mirëpresin dhe marrin përsipër organizimin e vizitave, asistencës së studentëve dhe të praktikave të tyre mësimore; si edhe të stafit akademik dhe mbështetës së **Kolegjit Universitar “LUARASI”** me **“KMD”** si dhe të specialistëve të këtij të fundit në **Kolegjin Universitar “LUARASI”**, me qëllim realizimin e programeve të përbashkëta dhe me interes të ndërsjelltë.

Neni 2

Palët në bashkëpunim me njëra-tjetrën, dhe në masën që nuk cënon ndërsjelltas interesat dhe veprimtaritë e tyre, jane të gatshme që të bashkëpunojnë ndërmjet tyre për realizimin e shërbimeve, ofrimin e ekspertizës e konsulencës shkencore dhe pjesëmarrjen në veprimtari të përbashkëta promociionale.

Neni 3

Palët shprehen të gatshme të asistojnë njëra-tjetrën, brenda mundësive të tyre dhe në respekt të politikave, procedurave dhe standardeve teknike, etike, mjedisore, shëndetësore e ligjore që garantojnë mbarëvajtjen e veprimtarive të tyre, në kuadër të zhvillimit të veprimtarive të përbashkëta, për qëllime studimore dhe shkencore.

Neni 4

Palët e kësaj marrëveshje konfirmojnë nevojën e përpjekjeve për të promovuar dhe

rritur ndërgjegjësimin në lidhje me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit në nivel shkencore dhe akademike dhe angazhohen të punojnë së bashku në këto aspekte:

- Praktika mësimore për studentët, për t'u njohur me bazën ligjore, raste konkrete në lidhje me problemet që lidhen me diskriminimin
- Aktivitete të ndryshme që lidhen me ndërgjegjësimin për problemet e diskriminimit
- Leksione të hapura që lidhen me çdo çështje diskriminimi.

Neni 5

Palët njohin paraprakisht se kjo Marrëveshje nuk është një kontratë, por përbën një dokument sipas të cilit palët deklarojnë paraprakisht vullnetin e tyre të lirë për një bashkëpunim në realizimin e projekteve dhe veprimtarive të përbashkëta.

Neni 6

Palët janë të vetëdijshme se çdo bashkëpunim i mundshëm në të ardhmen do të jetë subjekt i protokolleve të veçanta, të cilat do të rregullojnë në mënyrë specifike detajet e bashkëpunimit në fjalë.

Neni 7

Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë kohe të pakufizuar dhe mund të prishet nga palët me anën e një njoftimi paraprak me shkrim të palës tjetër jo më pak se 1(një) muaj para.

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI

Kolegji Universitar "LUARASI"

ROBERT GAJDA

KOMISIONER

Datë: 24/04/2019

Prot: 622



Prof.Dr. Et'hëm RUKA
Rektor

Datë: 24/04/2019

Prot: 93

